

URDHËR
Nr. 349, datë 17.6.2022

**PËR CAKTIMIN E FUSHËS SË VEPRIMTARISË DHE DETYRAT E
ZËVENDËSMINISTRIT NË MINISTRINË E ARSIMIT DHE SPORTIT**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të pikës 2, të nenit 6, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”; të nenit 22, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; të nenit 11, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”; dhe të vendimit nr. 523, datë 22.9.2021, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Zëvendësministri i Arsimit dhe Sportit, z. Endrit Hoxha, të ndjekë çështjet që kanë të bëjnë me:

- a) procedurat e hartimit dhe të zbatimit të politikës shtetërore në fushën e sportit;
- b) zbatimin e politikave shtetërore në fushën e edukimit fizik dhe të sportit në sistemin arsimor;
- c) përmbushjen e objektivave të parashikuar në Planin 300-ditor të Qeverisë për pjesën që i përket sportit;
- d) sigurimin e bashkëpunimit me organizatat sportive dhe Agjencinë e Shërbimit të Sporteve, si institucioni që mbështet aktivitetin e tyre për zhvillimin e sportit në Republikën e Shqipërisë, duke respektuar pavarësinë e funksionimit të tyre, administrimin e objekteve sportive publike, që ka në juridiksion;
- e) mbështetjen dhe përfshirjen në veprimtari sportive të personave me aftësi të kufizuara dhe integrimin e tyre në jetën shoqërore nëpërmjet sportit;
- f) problematikat që parashtrohen nga organizatat sportive në Republikën e Shqipërisë (Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar, federatat sportive, shoqatat sportive, shoqëritë sportive, klubet sportive);
- g) monitorimin në vazhdimësi të marrëdhënieve të ndërsjella ndërmjet organizatave sportive dhe institucioneve të pushtetit qendror e vendor;
- h) ushtrimin, në mungesë dhe me porosi të ministrit, të kompetencave në fushën e sportit;
- i) i propozon ministrit pezullimin e dhënies së grandit apo ndryshimin e destinacionit të tij, nëse konstatohet se nuk zbatohen kërkesat e udhëzimit të përbashkët nr. 4, datë 25.2.2022, “Për mënyrën e përdorimit të fondit ‘grand/transfertë korrente e brendshme’ për federatat sportive olimpike, Komitetin Olimpik Kombëtar Shqiptar dhe Organizatën Kombëtare Antidoping”, ose për arsye/shkaqe të tjera të motivuara;
- j) mbajtjen e marrëdhënieve me EPAS-in (organizata evropiane përgjegjëse për politikën e sportit pranë Këshillit të Evropës);
- k) monitorimin e analizave antidoping;
- l) trajtimin e sportistëve elitarë, sipas kërkesave të federatave.

2. Zëvendësministri mund të kërkojë informacion me shkrim për çdo korrespondencë shkresore të administratës së Ministrisë së Arsimit dhe Sportit për çështjet në fushën e sportit.

3. Ngarkohet zëvendësministri, që brenda 10 ditëve nga miratimi i këtij urdhri, të detajojë planin e punës me veprimet dhe afatet konkrete për përmbushjen e detyrave të përcaktuara më sipër. Plani i punës miratohet nga ministri.

4. Zëvendësministri bashkëpunon dhe koordinon punën me zëvendësministrat e tjerë të Arsimit dhe Sportit për çështje të caktuara që konvergjojnë në fushën e përgjegjësisë dhe veprimtarisë së dy ose më shumë zëvendësministrave.

5. Ngarkohet stafi administrativ i Ministrisë dhe institucionet e varësisë, që të asistojnë dhe mbështesin zëvendësministrin për përmbushjen e detyrave të ngarkuara.

6. Ngarkohet zëvendësministri, z. Endrit Hoxha, për zbatimin e këtij urdhri dhe Drejtoria e Burimeve Njerëzore, për njoftimin e urdhrit, drejtorive të ministrisë dhe institucioneve të varësisë së Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I ARSIMIT DHE SPORTIT

Evis Kushi